



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:261780
Datë: 30.01.2024
Numri i dokumentit: 05258543

AA.nr.73/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi, kryetar, Valon Totaj dhe Delushe Halimi, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Besarta Sopaj, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditëses, I... M..., të cilën me autorizim e përfaqëson av. M... M... nga Prishtina, kundër të paditurve, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Puneve të Brendshme, Policia e Kosovës në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Ministria e Drejtësisë-Avokatura Shtetërore me bazë juridike kompensim i te ardhurave nga marrëdhënie e punës, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës se dytë të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1892/2018, të datës 23.11.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 05.01.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuara ankesa e të paditurës se dytë Ministria e Puneve të Brendshme, Policia e Kosovës me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1892/2018, i datës 23.11.2022, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1892/2018, të datës 23.11.2022, në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit, është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditëses, I... M... dhe është obliguar Ministria e Punëve të Brendshme/ Policia e Kosovës që paditëses, I... M... ti bëhet kompensimi dhe atë shumën neto në vlerën e përgjithshme 28,346.63 € (njëzet e tetë mijë e treqind e katër dhjetë e gjashtë euro e gjashtëdhjetë e tre cent), kontributin pensional në emër të paditëses 5% në shumën 1,564.60 € (një mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e katër euro e gjashtëdhjetë cent), kontributin pensional në emër të punëdhënësit 5% në shumën 1,564.60€ (një mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e katër euro e gjashtëdhjetë cent), tatimin në të ardhura personale në shumë prej 1,378.17€ (një mijë e treqind e shtatëdhjetë e tetë euro e shtatëmbëdhjetë cent), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka paraqitur e autorizuar e të paditurës se dytë Ministria e Puneve të Brendshme, Policia e Kosovës me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Ministria e Drejtësisë-Avokatura Shtetërore për shkak të: shkeljeve të dispozitave ligjore të procedurës administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që të aprovohet ankesa e të paditurës se dytë Ministria e Puneve të Brendshme, Policia e Kosovës si e bazuar me ligj dhe të prishet aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë A.nr.1892/2018, i datës 23.11.2022 dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditëses, avokat M... M... nga Prishtina, ka parashtruar përgjigje në ankesën e të paditurës së dytë, duke propozuar që ankesa të refuzohet si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

Gjykata e Apelit shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore në ankesë, përgjigjen në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuara

Nga shkresat e lëndës rezulton se e Gjykata e Apelit këtë lëndë e ka kthyer në rigjykim dhe rivendosje me arsyetimin se, në pjesën e prishur të aktgjykimit, i njëjti përmban të meta në aspektit të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, lidhur me lartësinë e të ardhurave të cilat e paditura ka për obligim t'ia paguajë paditëses sipas ekspertizës financiare, të meta të cilat duhet eliminuar në ri-procedurë. Gjykata e shkallës së parë për të vërtetuar drejt gjendjen faktike e ka aprovuar propozimin e paditëses për nxjerrën e provës me ekspertizë financiare. Seanca e shqyrtim kryesor e mbajtur e dt.23.11.2022, është mbajtur në prezencën e paditëses, përfaqësuesit të saj, përfaqësuesit të të paditurit, ekspertës financiarë, si dhe në mungesë të palës së interesit, MPB/Policisë së Kosovës, (MPB/PK) e ftuar me rregull përmes të autorizues së tij, Avokaturës shtetërore, konform nenit 41 të LKA-së.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditëses, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditëses e aprovon si të bazuar, duke vendos si ne dispozitivin e tij. Me arsyetim se gjykata pas administrimit te provave dhe vlerësimit te tyre një nga një e së bashku respektivisht ekspertizës financiare te nxjerrë për çështjen e paditëses e cila nga gjykata u vlerësua përmbajtjesore dhe e sakte duke u inkorporua dhe vërejtjet e të paditurës ka ardhure në përfundim qe ti njehet paditëses e drejta në kompensimin e të ardhurave personale në mënyrë retroaktive prej datës së ndërprerjes së marrëdhënies së punës, dt.13.11.2015 deri në datën e kthimit të saj në vendin e punës, dt.01.04.2022 dhe atë shumën neto në vlerën e përgjithshme 28,346.63€ (njëzet e tetë mijë e treqind e katër dhjete e gjashtë euro e gjashtëdhjetë e tre cent), kontributin pensional në emër të paditëses 5% në shumën 1,564.60€ (një mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e katër euro e gjashtëdhjetë cent), kontributin pensional në emër të punëdhënësit 5% në shumën 1,564.60€ (një mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e katër euro e gjashtëdhjetë cent), tatimin në të ardhura personale në shumë prej 1,378.17€ (një mijë e treqind e shtatëdhjetë e tetë euro e shtatëmbëdhjetë cent). Krejt kjo pasi kërkesa kryesore që ka te bej me kthimin ne punë te paditëses tashme veç se është realizuara sipas Aktgjykimet të kësaj gjykate me dt.01.04.2022. Gjykata e shkallës së parë përmes Pasqyrës së Llogarisë së Trustit, ka vërtetuar se gjatë periudhës së ndërprerjes së marrëdhënies së punës, saktësisht periudhën 01.03.2016 – 02-2016, paditësja ka pranuar kompozim te mjeteve nga Ministria e Financave, e që ky

kompensim gjatë llogaritjes përmes ekspertizës është zbritur dhe hequr nga llogaritja. Gjykata e shkallës së parë ia fali në tërësi besimin ekspertizës financiare të dt. 11.10.2022 dhe për të njëjtën gjykata konstatoi se është profesionale dhe e bindshme. Nga kjo ekspertizë gjykata ka konstatuar se për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës në mënyrë të kundërligjshme, paditësja nuk i ka realizuar pagat që do t'i takonin për periudhën kontestuese si në vijim: shumën neto në vlerë 28,346.63€, kontributin pensional në emër të paditëses 5% në shumën 1,564.60€, kontributin pensional në emër të punëdhënësit 5% në shumën 1,564.60€ dhe tatimin në të ardhura personale në shumë prej 1,378.17 €. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar edhe pretendimet e të paditurit, KPMSHC-së, te seancës pasi që me aktgjykimin e GJTHP, vendimi i të paditurës është shfuqizuar dhe i njëjti aktgjykim është vërtetuar nga Gjykata e Apelit, atëherë i mbetet gjykatës që në mënyrë meritore të vendos për këtë çështje meqë është realizuar kërkesa kryesore për kthimin e punë gjykata për ardhurat ka vendosur në mënyrë meritore si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar edhe pretendimet e palës se interesit MPB/PK se përket se paga bazë nga viti 2015 e deri në vitin 2017 duhet të jetë 291.36 euro e ku u konstatua se ekspertiza sa i përket kësaj periudhe është e llogaritur në mënyrë të saktë. Për vendosjen si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata pati parasysh vërejtjet e Gjykatës së Apelit përmes Aktgjykimit AA.nr.89/21, të dt. 07.03.2022.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimin i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar kërkesëpadinë, në drejtim të pretendimeve në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadija e paditëses është e bazuara.

Sa i përket pretendimeve ankimore të përfaqësueses të autorizuar të paditurës së dytë Ministria e Puneve të Brendshme, Policia e Kosovës me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Ministria e Drejtësisë-Avokatura Shtetërore, se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje thelbësore të dispozitave procedurale, këto pretendime ankimore nuk qëndrojnë, ngase aktgjykimin i gjykatës së shkallës së parë nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës administrative dhe kontestimore, e as me shkelje të tjera të cilat do të ndikonin në drejtëshmërinë dhe ligjshmërinë e aktgjykimit të goditur. Meqë gjykata e shkallës së parë ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës KPMSHC në përgjigje në padi dhe të paditurës së dytë MPB, pastaj ka caktuar seancat dhe seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së dhe LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, se gjykata e shkallës së parë nuk i ka marrë në konsideratë provat materiale në bazë të cilave e paditura ia ka dërguar gjykatës me parashtrësë me datë 11.11.2022. Drejtoria për Buxhet dhe Financa e Policisë së Kosovës ka konfirmuar se paga në ekspertizën e ekspertit është paraqitur gabim në shumën prej 303.01 euro, pasi që duhet të jetë 291.36 euro dhe se nuk ka pasur rritje të pagave në Policinë e Kosovës prej janarit të vitit 2018. Këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoi, për faktin se vlerëson se të njëjtat janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme, sepse gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të kërkesëpadiës së paditëses, ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditëses janë të bazuara, pasi që është vërtetuar se ekspertiza sa i përket kësaj periudhe është e llogaritur në mënyrë të saktë. Andaj, në këtë drejtim kolegji i kësaj gjykate konsideron se pretendimet ankimore të përfaqësueses të autorizuar të paditurës së dytë, janë në

kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, ngase në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosur lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontest në arsyetimin e aktgjykimit, janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Andaj, pranë një gjendje të tillë faktike, kolegji i kësaj gjykate konsideron se aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Kolegji i kësaj gjykate ka shqyrtuar edhe pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar edhe të drejtën materiale. Këto pretendime ankimore, kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoi, ngase të njëjtat vlerëson se janë të paqëndrueshme dhe të pa argumentuara me prova konkrete të cilat do të gjenin mbështetje ligjore, dhe si të tilla janë pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Duke pasur parasysh se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditëses, e pasi që me pretendimet tjera ankimore një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës se dytë, u refuzua si e pa bazuara, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.73/2023, me datë 05.01.2024

Kryetari i kolegjit,
Ramiz Kuqi